

AKTI FINAL

I KONFERENCES DIPLOMATIKE MBI PROTOKOLLIN E PRANIMIT TE KOMUNITETIT EUROPIAN NE KONVENTEN NDERKOMBETARE TE EUROKONTROLL-it NE LIDHJE ME BASHKEPUNIMIN PER SIGURINE E NAVIGIMIT AJROR TE 13 DHJETORIT 1960, SIC ESHTË AMENDUAR SHUME HERE DHE KONSOLIDUAR NGA PROTOKOLLI I 27 QERSHORIT 1997

(Bruksel, 8 tetor 2002)

TE PLOTFUQISHMIT E

REPUBLIKES SE SHQIPERISE,
REPUBLIKES FEDERALE TE GJERMANISE,
REPUBLIKES SE AUSTRISE,
MBRETERISE SE BELGJIKES,
REPUBLIKES SE BULLGARISE,
REPUBLIKES SE QIPROS,
REPUBLIKES SE KROACISE,
MBRETERISE SE DANIMARKES,
MBRETERISE SE SPANJES,
REPUBLIKES SE FINLANDES,
REPUBLIKES FRANCEZE,
MBRETERISE SE BASHKUAR TE BRITANISE SE MADHE DHE IRLANDES SE VERIUT,
REPUBLIKES SE GREQISE,
REPUBLIKES SE HUNGARISE,
IRLANDES,
REPUBLIKES ITALIANE
ISH REPUBLIKES JUGOSLLAVE TE MAQEDONISE,
DUKATES SE MADHE TE LUKSEMBURGUT,
REPUBLIKES SE MALTES,
REPUBLIKES SE MOLDAVISE,
PRINCIPATES SE MONAKOS,
MBRETERISE SE NORVEGJISE,
MBRETERISE SE HOLLANDES,
REPUBLIKES PORTUGEZE,
RUMANISE,
REPUBLIKES SLLOVAKE,
REPUBLIKES SE SLLOVENISE,
MBRETERISE SE SUEDESE,
KONFEDERATES ZVICERANE,
REPUBLIKES CEKE,
REPUBLIKES SE TURQISE,
DHE
KOMUNITETIT EUROPIAN,

Mbledhur në Bruksel më 8 tetor 2002;

1. *Kanë adoptuar unanimisht* tekstin e një Protokolli i cili ndodhet në Aneksin e këtij Akti Final që ketej e tutje do të quhet "Protokolli i Pranimi", mbi pranimin e Komunitetit Europian ne Konventën Ndërkombëtare të EUROKONTROLL-it ne lidhje me Bashkëpunimin per Sigurinë e Navigimit Ajror të 13 dhjetorit 1960, siç është amenduar

shumë herë, dhe siç është konsoliduar nga Protokollin e hapur për nënshkrim më 27 qershor 1997, që këtej e tutje i quajtur "Konventa e rishikuar". Protokollin e Pranimit i sipër përmendur është hapur për nënshkrim në Bruksel më 8 tetor 2002.

2. *Kanë adoptuar* rezolutat e mëposhtme respektivisht në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin e Protokollit të Pranimit nga Palët Kontraktuese në konvencencën e tyre më të parë dhe implementimin e parakohshëm të Protokollit të Pranimit;

Konferenca:

Mbledhur në Bruksel më 8 tetor 2002;

Pasi kanë adoptuar unanimit Protokollin, që këtej e tutje të quajtur "Protokollin e Pranimit", mbi pranimin e Komunitetit Europian në Konventën Ndërkombëtare të EUROKONTROLL-it në lidhje me Bashkëpunimin për Sigurinë e Navigimit Ajror të 13 dhjetorit 1960, siç është amenduar shumë herë, dhe siç është konsoliduar nga Protokollin e hapur për nënshkrim më 27 qershor 1997, që këtej e tutje i quajtur "Konventa e rishikuar";

I. Rezoluta që nxit Palët Kontraktuese për të ratifikuar, pranuar ose miratuar Protokollin e Pranimit në konvencencën e tyre më të parë

Duke ditur që pranimi i Komunitetit Europian do të kontribuojë në mënyrë të rëndësishme ndaj qëllimeve dhe detyrave të EUROKONTROLL-it mbi termat dhe kushtet që përmbahen në Protokollin e Pranimit;

Duke kujtuar rezolutën e adoptuar nga Konferenca Diplomatike e 27 qershorit 1997 mbi Protokollin për të konsoliduar Konventën e EUROKONTROLL-it që nxit Palët Kontraktuese të Konventës së EUROKONTROLL-it për të ratifikuar Protokollin e sipër-përmendur të 27 qershorit 1997 në konvencencën e tyre më të parë;

Duke rënë dakort për rëndësinë e hyrjes në fuqi të Konventës së rishikuar dhe të Protokollit të Pranimit sa më shpejt të jetë e mundur;

Nxit nënshkruesit e Protokollit të Pranimit të ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë këtë Protokoll sa më shpejt të jetë e mundur.

I kërkon Drejtorit të Përgjithshëm të EUROKONTROLL-it të marri të gjitha masat praktike, në bashkëpunim me Shtetet nënshkruese dhe Komunitetin Europian, për të dhënë asistencë, nëse kërkohet, në procesin e ratifikimit, pranimit ose miratimit të Protokollit të Pranimit.

II. Rezoluta për implementimin e parakohshëm të Protokollit të Pranimit

Pas vërejtjes së Rezolutës për implementimin e parakohshëm të Protokollit Konsolidues adoptuar nga Konferenca Diplomatike për adoptimin e atij Protokollin më 27 Qershor 1997;

Duke konsideruar rëndësinë e një implementimi të bute dhe efikas të Protokollit të Pranimit;

Nxit të gjitha Shtetet e Komunitetit Europian që të krijojnë, mbështetur në të gjitha mundësitë e veta, kushtet për implementimin e parakohshëm të dispozitave të caktuara të Protokollit të Pranimit.

3. *Kanë adoptuar* deklaratat e përbashkëta të mëposhtme në mungesë të kompetencës së Komunitetit në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare dhe në koordinimin e KZHTV-së:

I. Deklarata e përbashkët në mungesë të kompetencës së Komunitetit në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare

Nënshkruesit e Protokollit për pranimin e Komunitetit European në Konventën Ndërkombëtare të EUROKONTROLL-it në lidhje me bashkëpunimin për Sigurinë e Navigimit Ajror të 13 Dhjetorit 1960, siç është amenduar shumë herë, dhe siç është konsoliduar nga Protokollin i hapur për nënshkrim më 27 Qershor 1997, që këtej e tutje do të quhet "Konventa e rishikuar",

Pas vënies re se Komunitetit European nuk ka kompetenca për momentin përse i përket politikave të mbrojtjes dhe sigurisë;

Duke marrë parasysh rolin e EUROKONTROLL-it siç është përcaktuar në dispozitat e Konventës së rishikuar në lidhje me çështjet ushtarake;

Bien dakort që:

Nëse kompetenca e Komunitetit European do të shtrihen edhe këto çështje do të lindte nevoja për të rishikuar nëse kjo gjë do të transformonte rrenjesisht shtrirjen e detyrimeve të tyre nën Konventë e rishikuar dhe si rrjedhojë nëse Protokollin sipas formës së tij aktuale mund të aplikohet në këto çështje.

II. Deklarata e përbashkët për koordinimin e KZHTV-së

Nënshkruesit e Protokollit për pranimin e Komunitetit European në Konventën Ndërkombëtare të EUROKONTROLL-it në lidhje me bashkëpunimin për Sigurinë e Navigimit Ajror të 13 Dhjetorit 1960, siç është amenduar shumë herë, dhe siç është konsoliduar nga Protokollin i hapur për nënshkrim më 27 Qershor 1997, që këtej e tutje do të quhet "Konventa e rishikuar",

Pas shqyrtimit të dispozitave të Konventës së rishikuar në lidhje me koordinimin e aktiviteteve të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe vlerësimit (KZHTV) në fushat e mbuluara nga kjo Konventë;

Pas vënies re se Neni 2.1.(h) i Konventës së rishikuar është i aplikueshem për koordinimin e aktiviteteve të KZHTV-së midis EUROKONTROLL-it dhe Palëve Kontraktuese të tij;

Pas vënies re se koordinimi i organizuar nga Agjencia e EUROKONTROLL-it sipas Nenit 1.5 (i) të Statutit të saj ka të bëjë me aktivitetet e veta të KZHTV-së dhe ato të organizmave të ATM;

Bien dakort që:

- "koordinimi i aktiviteteve të KZHTV-së" është shkëmbimi i pikepamjeve, informacionit dhe eksperiences rreth programve dhe aktiviteteve të KZHTV-së në fushën e menaxhimit të trafikut ajror; objektivat e tij kryesore janë për të nxitur kryerjen e plote të punës dhe për të mënjeluar dublimin e saj;

- në koordinimin e aktiviteteve të tyre të KZHTV-së, të gjitha palët e përfshira do të kene parasysh objektivat e përgjithshme, kompetencat, përgjegjësitë administrative, menaxhuese e buxhetore dhe procedurat e institucioneve të tyre respektive ose organizmave të besuar për zbatimin e programeve të KZHTV-së, si dhe rregullave të tyre mbi pjesëmarrjen, propagandimin dhe të drejtat e pronës intelektuale;
- Palët Kontraktuese do të jenë të lira për të vendosur mbi strategjitë, programet dhe projektet e tyre të KZHTV-së në përputhje me procedurat e tyre të brendshme.

4. *Kanë vërejtur* deklaratën e përbashkët të mëposhtme nga Shtetet nënshkruese të Protokollit Konsolidues dhe këtij Akti Final:

III. Deklarata e përbashkët në lidhje me hyrjen në fuqi të Protokollit Konsolidues dhe Protokollit të Pranimi, dhe në lidhje me nënshkrime të mëtejshme në Protokollin e Pranimi

Shtetet nënshkruese të Protokollit që konsolidon Knoventën Ndërkombëtare të EUROKONTROLL-it në lidhje me Bashkëpunimin për Sigurinë e Navigimit Ajror të 13 Dhjetorit 1960, siç është amenduar shumë herë, i hapur për nënshkrim më 27 qershor 1997, që këtej e tutje i quajtur "Protokolli Konsolidues", dhe nënshkruesit e Aktit Final të Konferencës Diplomatike mbi Protokollin për pranimin e Komunitetit European në Konventën e EUROKONTROLL-it, hapur për nënshkrim më 8 tetor 2002, që këtej e tutje i quajtur "Protokolli i Pranimi";

Dëshirues për të qartësuar kushtet në lidhje me hyrjen në fuqi të Protokollit Konsolidues dhe Protokollit të Pranimi;

Konfirmojnë interpretimin e tyre të Nenit II, paragraf 3, të Protokollit Konsolidues sipas të cilit Protokolli i lartpërmendur do të hyjë në fuqi kur të gjitha Shtetet që janë palë të Konventës së EUROKONTROLL-it në 8 tetor 2002, kanë depozituar instrumentat e tyre ligjore të ratifikimit, pranimi ose miratimit të Protokollit Konsolidues.

Ranë dakort që EUROKONTROLL-i do të marrë hapat e duhur për të siguruar, kur merr në konsideratë një kërkesë për t'u pranuar në Konventën e EUROKONTROLL-it dhe për një autorizim për të nënshkruar Protokollin Konsolidues, që angazhimet e mjaftueshme janë marrë për nënshkrimin dhe për ratifikimin, pranimin ose miratimin, e Protokollit të Pranimi.

PROTOKOLL

MBI PRANIMIN E KOMUNITETIT EUROPIAN NE KONVENTEN NDERKOMBETARE TE EUROKONTROLLIT NE LIDHJE ME KOOPERIMIN PER SIGURINE E NAVIGIMIT AJROR TE 13 DHJETORIT 1960, DHE I NDRYSHUAR ME ANE TE AMENDIMIT DHE I KONSOLIDUAR NGA PROTOKOLLI I 27 QERSHORIT 1997.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISE
REPUBLIKA E AUSTRISE
MBRETRIA E BELGJIKES
REPUBLIKA E BULLGARISE
REPUBLIKA E QIPROS
REPUBLIKA E KROACISE
MBRETRIA E DANIMARKES
MBRETRIA E SPANJES
REPUBLIKA E FINLANDES
REPUBLIKA E FRANCES
MBRETRIA E BASHKUAR E BRITANISE SE MADHE DHE IRLANDES SE VERIUT
REPUBLIKA E GREQISE
REPUBLIKA E HUNGARISE
IRLANDA
REPUBLIKA E ITALISE
ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISE
DUKATI MADH I LUKSEMBURGUT
REPUBLIKA E MALTES
REPUBLIKA E MOLDOVES
PRINCIPATA E MONAKOS
MBRETRIA E NORVEGJISE
MBRETRIA E HOLLANDES
REPUBLIKA E PORTUGALISE
RUMANIA
REPUBLIKA E SLLOVAKISE
REPUBLIKA E SLLOVENISE
MBRETRIA E SUEDE
KONFEDERATA E ZVICRES
REPUBLIKA E CEKISE
REPUBLIKA E TURQISE
DHE
KOMUNITETI EUROPIAN**

Ne lidhje me Konventen Nderkombetare te EUROKONTROLLIT PER Kooperimin per Sigurine e Navigimit Ajror te 13 Dhjetorit 1960, te amenduar nga Protokolli Shtese i 6 Korrikut 1970, me vone i amenduar nga Protokolli i 21 Nendorit 1978 dhe te gjitha te amenduara nga Protokolli i 12 Shkurtit 1981 si dhe te amenduara dhe te konsoliduara nga Protokolli i 27 Qershoorit 1997, ketej e tutje i referuar si "Konventa" dhe ne vecanti Neni 40;

Ne lidhje me pergjegjesite e dhena nga Traktati i vendosur i Komunitetit European i 25 Marsit 1957, dhe i rishikuar nga Traktati i Amsterdami i 2 Tetorit 1997, per Komunitetin European ne disa zona te caktuara te mbuluara nga Konventa;

Ndersa Shtetet Antare te Komunitetit Europian, Antaret e EUROKONTROLLIT, me adoptimin e Protokollit te konsolidimit te Konventes, e cila eshte hapur per nenshkrim me 27 Qershor 1997, deklaruan se nenshkrimet e tyre nuk paragjykojne kompetencat eskluzeve te Komunitetit ne disa zona te caktuara te mbuluara nga Konventa dhe te antaresise se EUROKONTROLLIT per qellim te ushtrimit te kompetencave te tilla eskluzeve.

Ndersa per qellim te pranimit te Komunitetit Europian kjo Konvente eshte qe te ndihmoje Organizaten Europiane per Sigurine e Navigimit Ajror, ketej e tutje e referuar si "EUROKONTROLL", per arritjen e objektivave te vendosura ne Konvente, per te qene nje bord i dallueshem i vetem dhe eficient per Manaxhimin e Trafikut Ajror te politike-berjes ne Europe.

Ndersa pranimi i Komunitetit Europian ne EUROKONTROLL kerkon sqarimin e menyres ne te cilen parashikimet e Konventes do te aplikohen tek Komuniteti Europian dhe te Shtetet e tij Antare.

Ndersa termat dhe kushtet e pranimit te Komunitetit Europian ne Konvente do ta aftesoje Komunitetin te ushtroje brenda EUROKONTROLLIT kompetenca te tilla, qe jane transferuar tek ai nga Shtetet e tij Anetare.

Ndersa marrveshjet per kooperimin me te gjere mbi perdorimin e aeroportit te Gjibraltarit i pranuar ne Londer me 2 Dhjetor 1987 nga Mbretria e Spanjes dhe Mbretria e Bashkuar me nje delegacion te perbashket nga Ministrat e Puneve te Jashtem te te dy vendeve dhe marreveshje te tilla, duhet te futen ne operim;

KANA PRANUAR SI ME POSHTE:

Neni 1

Komuniteti Europian, brenda suazes se kompteneces se tij pranuan ne Konvente termat dhe kushtet e shtruar ne kete Protokoll, ne perputhje me Nenin 40 te Konventes.

Neni 2

Per Komunitetin Europian brenda suazes se kompteneces se tij Konventa do te aplikojte sherbimet e navigimit ne rruge si dhe sherbimet e aerodromit per trafikun ajror ne Rajonet e Informacionit te Fluturimeve te Shteteve Antare te tij, qe jane ne liste ne Aneksin II te Konventes, te cilat jane brenda kufizimeve te aplikimit territorial te Traktatit te vendosur te Komunitetit Europian.

Aplikimi i Protokollit per aeroportin e Gjibraltarit kuptohet se do te kryhet pa paragjykime ne lidhje me pozicionin legal respektiv te Mbreterise se Spanjes dhe te Mbreterise se Bashkuar ne lidhje me mosmarrveshjet mbi sovranitetin mbi territorin ne te cilin aeroporti eshte vendosur.

Aplikimi i ketij Protokolli mbi aeroportin e Gjibraltarit do te pezullohet derisa rregullimet ne Deklaraten e Perbashket bere nga Ministrat e Jashtem te Mbreterise se Spanjes dhe te Mbreterise se Bashkuar me 2 Dhjetor 1987 te futen ne operim. Qeveria e Spanjes dhe Mbreteria e Bashkuar do te informojne Palet e tjera Kontraktuese per kete Protokoll ne daten e futjes ne operim.

Neni 3

Subjekt i parashikimeve te ketij Protokolli, parashikimet e Konventes do te interpretohen ne ate menyre qe te perfshihet Komuniteti European brenda suazes se kompetences se Komunitetit, dhe termat e ndryshem te perdorur per te percaktuar Palet Kontraktuese ne Konvente dhe perfaqesuesit e tyre te nenkuptohen ne menyre respektive.

Neni 4

Komuniteti European nuk do te kontriboje ne buxhetin e EUROKONTROLLIT.

Neni 5

Pa paragjykuar ushtrimin e te drejtave te tij te votuara sipas Nenit 6, Komuniteti European do te titullohet per te qene prezent dhe te perfshihet ne punen e te gjitha bordeve te EUROKONTROLLIT, ne te cilen ndonje nga Shtetet Antare eshte titulluar te jete prezent si nje Pale Kontraktuese, dhe kur ceshtjet bien brenda kompetences se tij duhet te merret me te, me perjashtim te bordeve te cilat kane nje funksion auditimi.

Ne te gjitha bordet e EUROKONTROLLIT ku ata mund te marrin pjese, Komuniteti European do te prezantoje pozicionin e tij, brenda suazes se kompetencave te tij, ne perputhje me rregullat e tij institucionale.

Komuniteti European nuk mund te dorezoje kandidate per antaresi per bordet e zgjedhura te EUROKONTROLLIT, ai nuk mund te dorezoje kandidate per zyra ne bordet ne te cilat eshte titulluar te marre pjese.

Neni 6

1. Per vendimet ne ceshtjet ku Komuniteti European ka kompetenca eskuzive dhe per qellim te aplikimit te rregullave te parashikuara ne Nenin 8 te Konventes, Komuniteti European do te ushtroje te drejtat e votimit te Shteteve te tij Antare sipas Konventes si dhe votat dhe peshen e votave te Komunitetit European do te perdoren per percaktimin e maxhorances si eshte parathene ne Nenin 8 te Konventes. Kur Komuniteti voton, Shtetet e tij Antare nuk duhet te votojne:

Per qellim te vendosjes se numrit te Paleve Kontraktuese sipas kerkeses se Konventes per marrjen e vendimeve nga nje e treta e maxhorances, si eshte stipuluar ne fund te nen-paragrafit te pare te Nenit 8.2, Komuniteti do te konsiderohet se perfaqeson Shtetet e tij Antare, te cilet jane Antare te EUROKONTROLLIT.

Nje vendim i propozuar ne lidhje me nje ceshtje specifike, qe do te votohet ne Komunitetin European duhet te shtyhet ne nje Pale Kontraktuese e Konventes, qe nuk eshte antar i Komunitetit European nese kerkohet ne kete menyre. Shtyrja duhet te perdoret per konsultime midis Paleve Kontraktuese ne Konvente, te ndihmuara nga Agjensia e EUROKONTROLLIT, mbi vendimin e propozuar. Ne rast te nje kerkese te tille, marrja e nje vendimi mund te shtyhet per nje periudhe maksimum prej gjashte muaj.

2. Per vendimet ne ceshtjet ku Komuniteti European nuk ka kompetenca eskuzive, Shtete Antare te Komunitetit European duhet te votojne ne perputhje me te drejtat e tyre te votimit sipas parashikimit ne Nenin 8 te Konventes, dhe Komuniteti European nuk duhte te votoje.

3. Komuniteti European duhet te informoje mbi nje baze rast pas rasti Palet e tjera Kontraktuese ne Konvente te rasteve ku, ne lidhje me ceshtje te ndryshme te axhendes se Asamblese se Pergjitheshme, Keshilli dhe bordet e tjere deliberativ, ne te cilat Asambleja e Pergjitheshme dhe Keshilli kane deleguar fuqite e tyre, do te ushtroje te drejtat e votimit sipas parashikmit te nen-paragrafit 1 me siper. Keto detyrime gjithashtu duhet te aplikohen kur vendimet jane marre me korespondence.

Neni 7

Qellimi i kompetencave te transferuara tek Komuniteti eshte treguar ne terma te pergjitheshme ne nje deklarate me shkrim te pergatitur nga Komuniteti European ne kohen e nenshkrimit te ketij Protokolli.

Kjo deklarate mund te modifikohet perkatesisht me ane te njoftimit nga Komuniteti European tek EUROKONTROLLI. Ajo nuk zevendeson ose ne ndonje menyre te kufizoje ceshtje te cilat mund te mbulohen nga njoftimet e Komunitetit, qe ka kompetence ti beje para vendim marrjes se EUROKONTROLLIT me ane te votimit formal ose ne ndonje forme tjeter te ndryshme.

Neni 8

Neni 34 i Konventes duhet te aplikohet per cdo mosmarreveshje te ngritur midis dy ose me shume Paleve Kontraktuese dhe EUROKONTROLLIT ne lidhje me interpretimin, aplikimin ose zbatimin e ketij Protokolli, perfshi ekzistencen e tij, vlefshmerine dhe perfundimin.

Neni 9

1. Protokolli do te hapet per nenshkrim nga Shtetet nenshkruese te Protokollit, qe konsolidon Konventen Nderkombetare te EUROKONTROLLIT ne lidhje me Kooperimin per Sigurine e Navigimit Ajror te 13 Dhjetorit 1960, i ndryshuar me amendimet, i hapur per nenshkrim me 27 Qershor 1997, ketej e tutje i referuar si "Protokoll i Konsolidimit" dhe Komunitetit European.

Ai gjithashtu do te jete i hapur para dates se futjes se tij ne force per nenshkrim nga ndonje Shtet i autorizuar plotesisht te nenshkruaj Protokollin e Konsolidimit, ne perputhje me Nenin II te ketij Protokolli.

2. Ky Protokoll do te jete subjekt i raktifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do te depozitohen nga Qeveria e Mberterise se Belgjikes.
3. Ky Protokoll do te futet ne fuqi pasi ai te jete ratifikuar, pranuar ose miratuar, nga njera ane, nga Shtetet nenshkruese te cilat jane gjithashtu nenshkruese te Protokollit te Konsolidimit, dhe nga te cilat kerkohet ratifikimi, pranimi ose miratimi per futjen ne fuqi e Protokollit te Konsolidimit, dhe nga ana tjeter, nga Komuniteti European, ne ditën e pare te muajit te dyte pas depozitimit te instrumentit te fundit te ratifikimit, pranimit ose miratimit, qe Protokolli i Konsolidimit te futet ne fuqi ne kete date. Ne rast se ky kusht nuk eshte plotesuar, ai do te futet ne fuqi ne te njejten date si dhe Protokolli i Konsolidimit.

4. Ky Protokoll do te futet ne fuqi ne lidhje me nenshkruet te tille, qe kane depozituar instrumentet e tyre te ratifikimit, pranimet ose miratimit pas futjes ne fuqi ne diten e pare te muajit te dyte ne vijim te depozitimit te instrumenteve perkates te ratifikimit, pranimet ose te miratimit.
5. Qeveria e Mbreterise se Belgjikes duhet te njoftoje Qeverite e Shteteve te tjera nenshkruet te ketij Protokollit dhe Komunitetin European te cdo nenshkruesi, te cdo depozitimi te instrumentit te ratifikimit, pranimet ose miratimit dhe cdo date te futjes ne fuqi te ketij Protokollit ne perputhje me paragrafet 3 dhe 4 me siper.

Neni 10

Cdo pranim ne Konvente pas futjes se saj ne fuqi do te perfaqesoje gjithashtu pelqimin per te gene i lidhur nga ky Protokoll. Parashikimet e Nenit 39 dhe 40 te Konventes gjithashtu do te aplikohen ne kete Protokoll.

Neni 11

1. Ky Protokoll do te mbetet ne fuqi per nje periudhe te pakufizuar.
2. Nese te gjithe Shtetet Antare te EUROKONTROLLIT, te cilet jane Antare te Komunitetit European terhiqen nga EUROKONTROLLI, njoftimi i terheqies nga Konventa, gjithashtu dhe nga ky Protokoll do te konsiderohet si i dhene nga Komuniteti European se bashku me njoftimin e terheqies sipas Nenit 38.2 te Konventes te Shtetit te fundit Antar te Komunitetit European te terhequr nga EUROKONTROLLI.

Neni 12

Qeveria e Mbreterise se Belgjikes, duhet te rregjistroje kete protokoll me Sekretarin e Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara ne perputhje me Nenin 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara dhe me Keshillin e Organizates se Aviacionit Civil Nderkombetar ne perputhje me Nenin 83 te Konventes mbi Aviacionin Civil Nderkombetar nenshkruar ne Cikago me 7 Dhjetor 1944.